



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 korrik 2019

Nr. ref.: KK 154/19

VENDIM PËR VAZHDIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME

në

rastin nr. KO65/19

Parashtrues

Avokati i Popullit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
nenit 32 (paragrafi 1), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76
(paragrafi 2), neni 2 (paragrafi 7) dhe 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/L-
010 për Noterinë**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e nenit 32 (paragrafi 1), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76 (paragrafi 2) në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar), i cili ka hyrë në fuqi më 26 dhjetor 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve të kontestuarra të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk janë në pajtueshmëri me nenin 5 [Gjuhët] dhe me paragrafët 1 dhe 3, të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesi i kërkesës më tej kërkon që Gjykata Kushtetuese e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme dhe të pezullojë zbatimin e neneve të kontestuarra deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate, duke pretenduar se *“kërkesa është prima facie e bazuar dhe me nenet e kontestuarra të ligjit të kontestuar subjekteve të caktuara u shkaktohen dëme të pariparueshme ...”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 2, nënparagrafin 1, të nenit 113 (Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara) dhe në paragrafët 1 dhe 2, të nenit 116 (Efekti Juridik i Vendimeve) të Kushtetutës, në nenet 22, 27, 29 dhe 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullat 32, 56 dhe 57 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 19 korrik 2019, Kolegji Shqyrtues, shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, dhe i dhanë komentet e tyre. Gjyqtarët e Gjykatës në përbërje të plotë po ashtu dhanë komentet e tyre lidhur me raportin e Gjyqtarit raportues.
7. Të njëjtën datë, Gjyqtari raportues me qëllim të përfshirjes të të gjitha komenteve, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë vazhdimin të vendimit për masë të përkohshme të 20 majit 2019, për tre (3) muaj deri më 21 tetor 2019.

Përkitazi me vazhdimin e Vendimit për Masë të përkohshme

8. Sa i përket vazhdimin të Vendimit për Masë të Përkohshme si më lart, Gjykata rithekson se zbatimi i Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, më saktësisht i neneve të kontestuarra 76 (paragrafi 2), neni 2 (paragrafi 7) dhe neni 22 (paragrafi 1.3) do të mund të shkaktonte dëm të pariparueshëm në funksionimin e shërbimit të noterisë dhe interesit publik në Republikën e Kosovës.

9. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh që afati kohor i Masës së Përkohshme të vendosur nga Gjykata më 20 maj 2019 do të skadojë më 21 korrik 2019, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të Kërkesës, afati kohor i Masës së Përkohshme vazhdohet për tre (3) muaj.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 116.2 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullat 56 dhe 57 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 19 korrik 2019, njëzëri

VENDOS


- I. TË VAZHDOJË Masën e Përkohshme të miratuar më 20 maj 2019, për tre muaj shtesë;
- II. Kjo Masë e përkohshme vazhdohet deri më 21 tetor 2019;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi